



[Ministria e Drejtësisë]



DIE ÖSTERREICHISCHEN
RECHTSANWÄLTE

[Avokatët austriakë]

Ministria e Drejtësisë informon:

Shërbimi i avokatëve kujdestarë ("thirrje urgjente mbrojtësit")

Çdo i pandehur i një procedure penale ka të drejtë të zgjedhë një avokat mbrojtës (Neni 58 Kodi i Procedurës Penale).

Ju jeni arrestuar si i pandehur i një procedure penale ose për shkak të një flete arresti evropian ose për shkak të një kërkesë për ekstradim dhe jeni dërguar për marrje në pyetje të menjëhershme. Derisa ju shprehimisht nuk hiqni dorë nga kjo, para se të merreni në pyetje, duhet t'ju mundësohet të lajmëroni, të angazhoni dhe të autorizoni një avokat mbrojtës.

Në bazë të një marrëveshje me Ministrinë e Drejtësisë, Oda Austriake e Avokatëve, për këtë qëllim praktikon një shërbim të Avokatëve kujdestarë ("thirrje urgjente mbrojtësit"). Nëse ju nuk angazhoni një avokat mbrojtës të zgjedhur lirisht, keni mundësinë që në kuadër të shërbimit kujdestar të kontaktoni një "avokat mbrojtës kujdestar". Ky shërbim kujdestar ju takon nën kushtet vijuese:

Shërbimi kujdestar përfshin një bisedë telefonike dhe në bazë të kërkesës së pandehurit një këshillim personal me një avokat apo avokate, si dhe në rast nevojë edhe praninë e avokatit/es gjatë marrjes në pyetje (Nenet 164 ose 174 Par. 1 Kodi i Procedurës Penale) si dhe disa masa adekuate të nevojshme për mbrojtje (si kërkesa për caktimin e një avokati mbrojtës si ndihmë në procedurë në gjykatë etj.). Oda Austriake e Avokatëve posedon për këtë qëllim me një numër të shërbimit të kujdestarisë ("Hotline") i cili është aktiv çdo ditë nga ora 0.00 deri në ora 24.00 dhe përmes tij menjëherë mund të kontaktohet një avokat/e.

Autorizimi i caktuar në kuadër të shërbimit kujdestar shfuqizohet me lirimin e Juaj nga burgu ose me caktimin e paraburgimit/burgut më qëllim ekstradimi apo dorëzimi. Natyrisht se ju keni të drejtë, që edhe pas kësaj kohe të autorizoni avokatin/ën.

Këshillimi i parë përmes telefonit me një avokat mbrojtës është falas!

Në kuadër të kësaj bisede telefonike Ju do të informoheni konkret për llojin, dimensionin dhe shpenzimet e mundshme të shërbimeve, të cilat janë ofruar në kuadër të shërbimit të avokatëve kujdestarë.

Në çdo rast është falas përfaqësimi nga avokati mbrojtës në kuadër të marrjes në pyetje nga policia në rast se jeni:

- i verbër, i shurdhër, memec ose person me aftësi të kufizuar ose vuani nga ndonjë sëmundje psikike ose nga ndonjë kufizim i tillë (Neni 61 Par. 2 Pika 2 Kodi i Procedurës Penale) ose jeni i mitur (14 deri 17 vjeçar)¹ dhe
- nëse nuk jeni në gjendje të paguani një avokat mbrojtës të zgjedhur lirisht.

Në këtë rast ju mund të parashtroni kërkesën, që t'ju caktohet një avokat mbrojtës nga shërbimi kujdestar.² Nëse Ju jeni i mitur, nuk mund të hiqni dorë nga angazhimi i një avokati mbrojtës. Ju lutem keni parasysh se një pretendim i gabuar, se nuk jeni në gjendje t'i bartni shpenzimet për një avokat mbrojtës të zgjedhur, shpie deri në detyrimin e kthimit të shpenzimeve.

Hotline: 0800 376 386

¹ I mitur është një person që ka mbushur moshën 14 vjeçare por jo edhe atë 18 vjeçare. Moshë 14 vjeçare mbaron me kalimin e ditëlindjes së 14. I mituri është personi prej orës 0 të ditës pas ditëlindjes së 14-të e deri në ora 24 të ditës së ditëlindjes së 18-të.

² Për çdo rast falas është përfaqësimi nga ana e një avokati mbrojtës nga shërbimi kujdestar gjatë marrjes në pyetje në lidhje me kërkesën e paraburgimit përkatësisht burg me qëllim ekstradimi ose dorëzimi, nëse nuk jeni në gjendje t'i bartni shpenzimet për një avokat mbrojtës të zgjedhur lirisht. Nëse jeni i mitur kjo vlen edhe kur obligimi për pagesë të shpenzimeve për mbrojtje do t'ju vështirësoj përparimin e mëtutjeshëm ose ekzistojnë parakushtet e nenit 61 Par. 2 rreshti i parë i Kodit të Procedurës Penale.